



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 746 Prot.

Patos, më 13 / 03 / 2024



MIRATOHET
KRYETARI
Armand Ahmetaj

PROJEKT-VENDIM

Nr. 24 Datë 13 / 03 / 2024

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË TRANSPARENCËS NË PROCESIN E
VENDIMARRJES SË KËSHILLIT BASHKIAK PATOS PËR VITIN 2023**

Mbështetur në piken 3 të nenit 15 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 neni 120, *Vlerësimi i Performancës dhe Llogaridhënia e Këshillit dhe Sekretariatit* i rregullores “Për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Patos” ,Ligji nr. 146/2014 “Për të drejtën e Konsultimit Publik” neni 11 i VKB nr. 1 datë 27.01.2022 “Rregullorja për Konsultimet Publike të Këshillit Bashkiak”, po ju prezantojmë Raportin e Transparencës së Vendimarrjes së Këshillit Bashkiak për vitin 2023.

Ky Raport përmban informacion për:

Numrin e akteve të miratuara nga ograni publik përkatës gjatë vitit 2023.

Numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palet e interesuara gjatë seancave të dëgjësive publike:

Numrin e rekomandimeve të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimarrjes.

Numrin e takimeve publike të organizuara.

Referuar sa më sipër Këshilli i Bashkisë gjatë vitit 2023 ka marrë 85 (tetëdhjetë e pesë) vendime në total.

Nga këto vendime në total për 7 vendime janë realizuar konsultime publike.

Në lidhje me tematikat e tyre:

Vendime për çështje financiare /tatime/buxheti/ nivel pagash 18

Vendime për çështje projktesh infrastrukturore 1

Vendime për çështje urbane dhe pronash 4

Vendime për çështje sociale, ndihmë ekonomike 33

Vendime për çështje arsimit , bursa 2

Vendime për çështje të ndryshme 27

Për secilin projektvendim që ka kërkuar konsultim publik është përgatitur Njoftimi dhe Kalendari i konsultimeve i cili është publikuar në rrjetet sociale të Këshillit dhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Njoftimi dhe kalendari kanë pasur në përmbajtje elementët e përcaktuar nga ligji si data, ora, grupet e interesit dhe përshkrimi i projektaktit.

Në konsultimet publike kanë marrë pjesë anëtarët e këshillit sipas tematikave të konsultimeve publike. Procesverbalet janë mbajtur nga koordinatori i konsultimeve publike. Konsultimet publike janë realizuar në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë.

Pas mbajtjes së konsultimit publik procesverbali është protokolluar, një kopje gjendet në arkiven e bashkisë dhe një kopje është postuar në faqen zyrtare të këshillit të bashkisë. Sekretari i bashkisë i ka përcjell rekomandimet e marra drejtorisë përkatëse. Po ashtu edhe për dëgjesa publike përveç takimeve në terren është përdorur varianti online, ku në dispozicion të qytetarëve është vendosur emaili i sekretarisë së këshillit ku ata mund të dërgonin komentet e tyre. Nga kontrolli emailit nuk rezulton ndonjë reagim apo propozim nga ana e qytetarëve.

Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara:

Gjatë procesit konsultativ u regjistruan gjithsej 21 rekomandime konkrete.

Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara:

Nga 26 rekomandime u mbajtën parashysh 23 dhe 3 u kthyen me motivim të arsyetuar nga zyrtarët publik të cilët u angazhuan në organizimin dhe drejtimin e dëgjësive publike.

Regjistri i Konsultimeve Publike gjendet i publikuar online në faqen e Këshillit të Bashkisë. Për secilin konsultim publik pas përfundimit të tij publikohet një përmbledhje e aktivitetit së bashku me fotot përkatëse.

Një nga format e publikimit ka qenë dhe informacioni i ngarkuar në rrjetin social Fb Bashkia Patos, e cila është një faqe që përditësohet çdo ditë, si një tregues tjetër i transparencës.

Njoftimet zyrtare janë afishuar në stendën e afishimeve publike dhe në vendet e dukshme në ambiente publike.

Albiona Lamaj

Zv/ Kryetare

Enkelejda Ajazi

Kryetar Grupi

Eduart Faslliaj

Zv/ Kryetar

Erald Çepele

Kryetar Grupi